

Vendim nr. 97 datë 09.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 09.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (T) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: TAULANT KUQO, përfaqësuar nga avokat Gjergji Nole, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-2116 (127), datë 11.04.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajftueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 141, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 24.12.2008, përmes agjencisë “Leon-Tir”, kërkuesi ka transferuar në Mbretërinë e Bashkuar shumë prej 3.600 eurosh, e cila do të tërhiqej nga babai i tij, B.K., me qëllim blerjen e një automjeti në Angli. Kjo transfertë është shënuar në formularin e dërgesës së agjencisë dhe është nënshkruar nga kërkuesi, në cilësinë e klientit, si dhe agjenti i kësaj agjencie. Afati i tërheqjes së shumës, sipas rregullores së Unionit Financiar Tiranë (*Western Union*) të kohës ishte 45 ditë.

2. Në kushtet kur pronarja e automjetit në Angli është tërhequr nga marrëveshja e shitblerjes, për shkak të dëmtimit të automjetit gjatë transportit dhe bërjes së tij të papërdorshëm, tre ditë pas dorëzimit të kësaj shume, konkretisht në datën 27.12.2008, kërkuesi dhe i ati janë paraqitur në agjencinë “Leon-Tir” për ta tërhequr atë, pasi ky i fundit nuk ishte nisur për në Angli për disa arsye. Ata janë bërë me dije nga agjencia se shuma ishte tërhequr po në datën e kryerjes së transfertës nga persona të paraqitur si B.K.

3. Në datën 27.12.2008 kërkuesi i është drejtuar agjencisë “Leon-Tir” me ankim për moskthimin e shumës, për të cilin, në datën 08.01.2009, agjencia i ka vënë në dispozicion dokumentin përmes të cilit vërtetohej se shuma i ishte dhënë personit të paraqitur për tërheqjen e saj. Sipas shkresës së drejtorit ekzekutiv të agjencisë së datës 06.03.2009, shuma i ishte dorëzuar B.K., në dorëzimin e saj ishin respektuar procedurat e standardet dhe dorëzimi i saj vërtetohej përmes aktit përkatës.

4. Në zbatim të nenit 224/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), kërkuesi ka kërkuar caktimin e një eksperti kriminalist nga Drejtoria e Policisë Shkencore Tiranë, me qëllim kryerjen e ekspertimit grafik të firmës në aktin “*To recive money “Western Union”, datë 24.12.2008*”, për të përcaktuar nëse firma në rubrikën “*Costumer Signature*” ishte ose jo e personit të tretë B.K. Sipas aktit të ekspertimit, nënshkrimi nuk ishte i babait të kërkuesit dhe se ky subjekt nuk ishte paraqitur asnjëherë në zyrat e agjencisë në Angli.

5. Kërkuesi i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar detyrimin e shoqërisë Western Union t’i kthejë shumë prej 3.600 euro, të paguar për transfertë në Angli në emër të babait të tij, B.K., të patërhequr nga ky i fundit, si dhe t’i paguajë interesat e shpenzimet gjyqësore deri në momentin e ekzekutimit të vendimit. Sipas kërkuesit, në këndvështrim të nenit 913 të Kodit Civil (*KC*), me kontratën e porosisë së datës 24.12.2008, shoqëria Western Union kishte marrë përsipër të kryente transferimin në Angli në emër të B. K. të shumës 3.600 euro, për të cilën ai kishte paguar edhe komisionin prej 160 eurosh. Kjo shoqëri kishte detyrimin që, sipas nenit 921 të KC-së, të zbatonte porosinë me besnikëri dhe përkujdesje. Në kushtet kur babai i tij nuk ishte paraqitur asnjëherë në zyrat e agjencisë në

Angli, çka provohej edhe nga këqyrja e pasaportës së tij, përmes së cilës rezultonte se ai nuk kishte udhëtuar asnjëherë në shtetin anglez, shoqëria duhej t'i kthente shumë objekt padie së bashku me shpenzimet e transfertës e ato gjyqësore, pasi ajo kishte vepruar në kundërshtim me Manualin Ndërkombëtar të Shërbimit Western Union. Kështu, duke vepruar me faj në dëm të kërkuesit, shoqëria nuk kishte bërë identifikimin e personit që kishte tërhequr shumë në Angli dhe në formularin e dorëzimit të shumës nuk ishin shënuar të dhënat personale e nënshkrimi i personit që e kishte tërhequr atë. Në seancën e datës 19.04.2012 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për shtesë të objektit të padisë dhe bazës ligjore të saj. Sipas tij, ai kishte hequr dorë nga kontrata e porosisë, për rrjedhojë kërkonte kthimin e shumës, nënshkrimi për tërheqjen e së cilës ishte falsifikuar.

6. Gjatë gjykimit, shoqëria Western Union ka prapësuar se transfertat ishte bërë në përputhje me kërkesat e shërbimit, kërkuesi ishte pajisur me numrin konfidencial të transfertës, i cili i bëhej i ditur vetëm marrësit të shumës dhe askujt tjetër, si dhe se kjo transfertë ishte realizuar. Sipas shoqërisë, në formularin *“Paralajmërim për mashtrimet në internet”* të nënshkruar prej tij, kërkuesi kishte konfirmuar se marrësi i shumës ndodhej në shtetin ku do të dërgohej ajo, në pritje të tërheqjes së saj. Ndërkohë, të dhënat konfidenciale të transfertës ai i kishte vënë në dispozicion të shitësit të automjetit, i cili nuk kishte qenë marrësi i përcaktuar i dërgesës, ndonëse sipas formularit *“Paralajmërim për mashtrimet në internet”* ishte paralajmëruar për rrezikun e kryerjes së transfertave për blerje mallrash ose shërbimesh në internet, si dhe kur një i panjohur kërkonte dërgimin e parave. Për rrjedhojë, në këndvështrim të neneve 686 e vijues të KC-së, ajo kishte përmbushur detyrimin kontraktual, pasi shërbimi ishte kryer korrekt, sipas porosisë së kërkuesit.

7. Në përfundim të gjykimit të çështjes, me vendimin nr. 1408, datë 15.02.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Sipas gjykatës, kërkuesi i është drejtuar asaj me padi rivendikimi, sipas nenit 296 të KC-së, duke pretenduar cenimin e së drejtës subjektive të pronësisë, çka nuk mund të pranohet prej saj. Po kështu, në shtesën e objektit të padisë, kërkuesi kishte kërkuar edhe shtimin e bazës ligjore, duke kërkuar kthimin e shumës, bazuar në nenet 913, 928 dhe 270 të KPC-së, ndërsa në pretendimet përfundimtare ka pranuar heqjen dorë nga porosia. Sipas gjykatës, neni 928 i KC-së nuk parashikonte heqjen dorë të porositësit, por heqjen dorë nga kontrata të të porositurit, i cili në rastin konkret kishte përmbushur detyrimin e tij, duke realizuar me korrektësi veprimet për realizimin e detyrimit të rrjedhur nga kontrata. Shoqëria kishte realizuar kontratën, konkretisht dorëzimin e shumës prej 3.600 eurosh shtetasit B.K. ose personit të paraqitur si i tillë në zyrat

e Western Union të Mbretërisë së Bashkuar. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk mund të pretendonte më me padi tërheqjen nga kontrata. Po kështu, ndonëse padia ishte bazuar në të drejtën e kërkuesit, si porosites, për t'u tërhequr nga kontrata, në të parashtrohej mospërmbushja e detyrimeve kontraktuale. Në padi kërkuesi duhej t'u ishte referuar këtyre dispozitave.

8. Bazuar në ankimin e kërkuesit, me vendimin nr. 516, datë 20.02.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranimin e padisë dhe detyrimin e Western Unionit t'i kthejë kërkuesit shumën 3.600 euro. Kjo gjykatë ka arsyetuar, në thelb, se në rastin konkret bëhej fjalë për një kontratë porosie, përmes së cilës, kundrejt shpërblimit, konkretisht komisionit të transfertës prej 160 eurosh, shoqëria kishte marrë përsipër transferimin e shumës me qëllim që ajo të tërhiqej nga babai i kërkuesit. Në vënien në dispozicion të shumës prej 3.600 eurosh një personi pa mjet identifikimi dhe jo B.K., shoqëria Western Union kishte vepruar me faj, në kundërshtim me ligjin dhe rregulloren e saj. Ajo nuk kishte respektuar dhe zbatuar procedurat e përcaktuara në Manualin Ndërkombëtar të Western Union, për sa i takon identifikimit të personit që kishte tërhequr paratë, marrjes së emrit, mbiemrit e nënshkrimit të tij, mbajtjes së kopjes së dokumentit të tij të identifikimit, si dhe shënimit në formular të numrave të kartëmonedhave të paguara klientit.

9. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs shoqëria Western Union, e cila ka pretenduar, ndër të tjera, se gjykata e apelit kishte keqinterpretuar marrëveshjen e shërbimit të lidhur mes palëve, Rregulloren Ndërkombëtare të Western Unionit dhe dispozitat e KC-së, pasi kërkuesi kishte vepruar në kundërshtim me rregullat e shërbimit Western Unionit të njohura dhe nënshkruara prej tij, duke i dhënë informacionin konfidencial një personi tjetër. Po kështu, në formularin *“Dërgesë parash”* kërkuesi nuk kishte deklaruar asnjë të dhënë plotësuese lidhur me identifikimin e marrësit, përveç emrit e mbiemrit, siç mund të ishte tipi ose numri i dokumentit të identifikimit dhe nga verifikimet e bëra në zyrën e kësaj shoqërie në Angli rezultonte se B.K. kishte plotësuar kërkesat e shërbimit Western Union, për rrjedhojë nuk kishte asnjë arsye që transferta të mos paguhej.

10. Me vendimin nr. 00-2022-2116 (127), datë 11.04.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke vlerësuar se përfundimi i arritur nga gjykata e apelit ishte rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, për rrjedhojë vendimi i kësaj gjykate duhej të prishej, ndërsa vendimi i gjykatës së rrethit duhej të lihej në fuqi.

11. Në datën 20.03.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkuetit

12. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

12.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

12.1.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, në lidhje edhe me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim, pasi as ai dhe as përfaqësuesit e tij me prokurë nuk janë njoftuar nga Gjykata e Lartë për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit, çka e ka vendosur atë në kushte të pabarabarta me palën tjetër ndërgjyqëse.

12.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi arsyetimi i Gjykatës së Lartë është jologjik, kontradiktor dhe i pabazuar në provat e administruara në dosjen gjyqësore. Gjykata e Lartë arsyeton se neni 928 i KC-së nuk është lexuar drejt nga gjykata e apelit, ndërkohë që ky nen nuk është kuptuar drejt nga Kolegji Civil i saj. I porositori mund të heqë dorë nga kontrata, por nëse në marrëveshje është parashikuar e kundërta, ai përgjigjet për dëmet, përveçse kur heqja dorë bëhet për një shkak të drejtë. Ai ka hequr dorë nga porosia, pasi për faj të shoqërisë Western Union i është vjedhur shuma prej 3.600 eurosh. Fajësia u përket agjencive të Western Union dhe jo atij, siç ka arsyetuar Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Vendimi i kësaj gjykate është arbitrar, me gabime faktike e logjike, të tilla që asnjë gjykatë e arsyeshme nuk do t'i kishte bërë.

12.2. *E drejta e pronës*, si rrjedhojë e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuetit*

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

14. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-mujaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.

17. Në kërkesën drejtuar Gjykatës, kërkuesi ka pretenduar se në datën 10.02.2024 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për t’u njoftuar lidhur me vendimin e zbardhur të Kolegjit Civil të saj në lidhje me çështjen e tij, vendim i cili i është komunikuar me shkresën nr. 1315/1 prot., datë 15.03.2024. Në këto kushte, sipas tij, bazuar edhe në qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në çështjen “*Supergrav Albania*” sh.p.k. k. *Shqipërisë*, datë 09.05.2023, sipas të cilit afati 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual fillon nga momenti i marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor, ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

18. Për sa i përket këtij pretendimi, Kolegji thekson se, duke marrë parasysh edhe qasjen e GJEDNJ-së në çështjen “*Supergrav Albania*” sh.p.k. k. *Shqipërisë*, në rastet e

kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, pra nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dënim në një datë të ndryshme. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka vlerësuar se si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data në të cilën vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Lartë bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se sipas informacionit të vënë në dispozicion të Gjykatës në rrugë elektronike nga Gjykata e Lartë në datën 12.04.2024, vendimi nr. 00-2022-2116 (127), datë 11.04.2022 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt i ankimit kushtetues individual, është publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate në datën 30.09.2022, ndërsa kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë në datën 20.03.2024, pra përreth 1 vit e 5 muaj pas publikimit të vendimit në këtë faqe.

20. Për sa i përket kësaj periudhe, Kolegji evidenton se në ankimin kushtetues individual kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument ose provë, të tillë që të tregojë se ka qenë në pamundësi për t’u njohur me vendimin e kundërshtuar nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, se ka depozituar adresën elektronike të tij ose përfaqësuesit të tij ligjor për qëllime të komunikimit elektronikisht të vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë nga administrata e kësaj gjykate ose që vendimi të mos i jetë komunikuar nga kjo e fundit, duke mos arritur në këtë mënyrë të argumentojë para Gjykatës plotësimin e kriterit të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

21. Në këndvështrim të sa më sipër, duke pasur parasysh jurisprudencën kushtetuese, si dhe standardet e vendosur nga Gjykata, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* në kërkesën e tij sipas objektit. Në kushtet kur kriteri paraprak i parashikuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000 nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriteve të tjera të pranueshmërisë së ankimit kushtetues individual i kërkueses bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

22. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.